



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primljeno/Prodato Received/Delivery	23.05.2022	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtyrja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHCK	2967/2022		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOS**

A.nr.373/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. Nr. 373/2022, të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me përfaqësues juridik avokat me adresë rruga kundër organit të punësimit Komuna e Podujevës, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 23.05.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.373/2022 e datës 14.04.2022 e parashtruar nga ankuesi përmes avokatit

**A r s y e t i m**

Ankuesi, i punësuar në pozitën "Zyrtar për Shërbime Sociale 2" në Komunën e Podujevës, nëpërmjet postës përmes përfaqësuesit të tij me autorizim më datë 08.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se organi i punësimit me rastin e pensionimit të tij duhet ti bëjë kompensimin e pagës së trembëdhjetë (13) për çdo vit kalendarik në vlerën e pagës bazë, pagesën edhe të tri (3) pagave sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pagesën për Shpërblim Jubilarë si dhe pagesën për ushqim ditorë për ditët e pranisë në punë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të





ankuesit në Komunën e Podujevës. Më datë 05.05.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Podujevës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.protokolli 2096/2022 të datës 14.04.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim i datës 23.12.2021 nga \_\_\_\_\_ për avokatin \_\_\_\_\_ Kërkesë e datës 28.12.2021; Dëftesa për pranimin e dërgesës me nr.R2037636 i datës 28.12.2021; Akt Emërim i H.G. i datës 05.01.2016; Vërtetim me numër 3098 i datës 23.12.2021; Vërtetim me numër nr.263/21 i datës 23.12.2021; Lista e pagave e muajit Janar 2021; Letërnjoftim i H.G.; Pliko me numër R2213345 i datës 08.04.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 21.04.2022; Përgjigje në ankesë e datës 05.05.2022; Përvoja e punës e H.G. në simbnj; Vendim me Nr.218/2015 i datës 13.07.2015; Lista e pagave e muajit Dhjetor 2013; Lista e pagave e muajit shtator 2021; Pliko me numër R2213158;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të gjitha provave të parashtruar nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit \_\_\_\_\_ është e *pabazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi \_\_\_\_\_ sipas Akt Emërimit të datës 05.01.2016 është i punësuar në komunën Podujevës, në pozitën "*Zyrtar për Shërbime Sociale 2*", i cili përmes postës më datë 28.12.2021 ka parashtruar kërkesë tek Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunë së Podujevës për kompensimin e pagës së 13 për çdo vit kalendarik; pagën përcjellëse me rastin e pensionimit në vlerën e tri pagave mujore; pagën e shpërblimit jubilar dhe pagesën për ushqim ditor për ditët e praninë në punës krejt këto sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, mirëpo që nuk ka pranuar përgjigje nga Komuna e Podujevës.

Ankuesi në ankesën \_\_\_\_\_ e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që Komuna e Podujevës në pajtim me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive duhet të bëjë kompensimin: pagesën e pagës së 13 për çdo vit kalendarik; pagesën e pagës përcjellëse me rastin e pensionimit në vlerën e tri pagave mujore; pagesën e shpërblimit jubilar dhe pagesën për ushqim ditor për ditët e praninë në punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që duhet ti bëhet pagesa e pagës së 13 për çdo vit kalendarik, ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: "*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet*", mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: "*Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës*", bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: "*Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit*", mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e





kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes, andaj bazuar në këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar edhe në deponat e nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, kërkesa e ankuesit për këtë pretendim është e parashkruar dhe është pretendim i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit sa i përket pagesës së pagës përcjellëse me rastin e pensionimit në vlerën e tri pagave mujore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të përgjigjes në ankesë të datës 05.05.2022 të dërguar nga Komuna e Podujevës, është theksuar që pala ankuese ende nuk ka arritur moshën e pensionimit për faktin që tani është në moshën gjashtëdhjetë e tri (63) vjeç, si rrjedhojë nuk mund të kërkohej kompensim pa ndodhur ngjarja, kështu që ankuesi vetëm kur të arrij moshën e pensionimit mund të pretendoj për realizimin e kërkesave të tij sepse ende ankuesit nuk i ka përfunduar marrëdhënia e punës sipas Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik respektivisht nenit 60 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3. përcaktohet se: *1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon për shkak të ligjit kur, 1.3. plotësohet moshja për pensionim*". Po ashtu ankuesi duhet të ketë parasysh faktin që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është në fuqi, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ky pretendim ankimor i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që ti bëhet pagesa e shpërblimit jubilar, ka konstatuar që ankuesi në muajin dhjetor 2013 është kompensuar në vlerën 82.50 Euro në emër të shpërblimit jubilar, ndërsa në shtator 2021 i njëjti është kompensuar prapë në emër të shpërblimit jubilar në vlerën 194.60 Euro, në këtë rast Komuna e Podujevës ka kryer obligimin ligjor ndaj ankuesit lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar, duke vepruar në pajtim me dispozitat e Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil respektivisht me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 ku përcaktohet se: *"Nëpunësit civil, kanë të drejtat në vijim: shpërblimi i përvjetorit (jubile)"* si dhe nenin 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil ku përcaktohet se: *"Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil, nëpunësve civil, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune"*, ndërsa ky kompensim nuk mund të bëhet sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit se komuna e Podujevës nuk respekton Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive lidhur me kompensimin e pagesës për ushqim ditor për ditët e praninë në punës sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqenëse nga data 15.09.2017 Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshme, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse më nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente, atëherë kompensimi i ushqimit për ditët e pranisë në punë nuk mund të realizohet sipas kësaj marrëveshje, andaj këto pretendimet të ankuesit janë në kundërshtim me nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, dhe si të tilla janë të pabazuara.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për


Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda A.nr.373/2022

Çlirim Zeka

  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit
- Kryetarit të komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Personelit në komunën e Podujevës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

